

Marrëveshja

Neni 1- PALËT

Transferuesi/Shitësi

– Bayindir Bank Co./
Buyukdere Caddesi no. 143 (34394)
Esentepe/Istanbul

Përfitues/Blerësi

– Calik- Seker Consortium Investment Co.
Keresteciler Sitesi Fatih Caddesi Selvi Sok.
No. 18 K.3 (34010), Merter, Istanbul

Neni 2- OBJEKTI I MARRËVESHJES

Mbulon transferimin dhe kalimin e 878.655 të aksioneve të Bankës Kombëtare Tregtare (BKT) me një vlerë nominale prej 8.786.550 USD që i korrespondojnë 60% të aksioneve që janë nën kontrollin e Bayindirbank Co. direkt ose indirekt tek Përfituesi/ Blerësi.

Neni 3- PËRKUFIZIMET

Termat e mëposhtëm do të kenë kuptimet korresponduese siç përdoren në këtë marrëveshje

Marrëveshje – do të ketë kuptimin e kësaj Marrëveshje të lidhur midis Transferuesit/Shitësit dhe Përfituesit/Blerësit.

Pjesëmarrje – do të ketë kuptimin Banka Kombëtare Tregtare (BKT)

Aksion – do të thotë përqindja e kapitalit principal të Pjesëmarrjes e ndarë në një numër të caktuar (nominal) vlerash dhe dhënia e së të drejtës dhe detyrimeve të partneritetit (i lidhur ose jo me aksionet),

Data e transferimit – do të ketë kuptimin e datës në të cilën Aksionet e Pjesëmarrjes janë caktuar dhe transferuar nga Transferuesi/Shitësi tek Përfituesi/Blerësi sipas legjislacionit shqiptar,

Bilanci i transferimit – do të ketë kuptimin e bilancit që pranohet nga palët që me Datën e Transferimit dhe integrohet si suplement duke u bërë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

Fjalët e përdorura në numrin njëjës në këtë Marrëveshje do të kenë gjithashtu kuptimin e shumës.

Neni 4- DETYRIMET E PALËVE

4.1 Përfituesi/Blerësi deklaron dhe njeh në mënyrë të përvokueshme se ka shqyrtuar Bilancin e Pjesëmarrjes të datës 31/12/2003 dhe pranon të gjitha të drejtat dhe detyrimet e këtij bilanci.

4.2 Çdo sipërmarrje, detyrim, marrëveshje e ekzekutuar me 3 palët dhe korporatat për vijueshmërinë e aktiviteteve të Pjesëmarrjes do të konsiderohet si i pranuar nga Përfituesi/Blerësi. Të gjitha kushtet dhe kompensimet penale që lindin nga dështimi i performancës së Përfituesit/Blerësit pasi transferimit të Aksioneve të Pjesëmarrjes të Marrëveshjes, sipërmarrjet dhe detyrimet e lart përmendura ose nga përfundimi i Marrëveshjeve do të paguhet nga Përfituesi/Blerësi.

4.3 Çdo pagesë për zgjidhje kontrate pune (mbarim i periudhës së punësimit) dhe pagesa të tjera në vend të njoftimit që do të llogariten gjatë periudhës së vlefshme dhe pagave që nga Data e Transferimit në lidhje me personelin e Pjesëmarrjes që është subjekt i kësaj Marrëveshjeje, si edhe tarifa dhe bonuse të paguara që i takojnë periudhës përpara Datës së Nënshkrimit, si edhe diferencat e tyre dhe pagat për leje të pakonsumuar në lidhje me periudhën e mëparshme dhe të gjitha të drejtat e tjera do të jenë përgjegjësi e Përfituesit/Blerësit. Megjithatë, dispozitat e Nenit 5.2 do të prevalojnë në rastin e zbatimit të Nenit 4.1, 4.2 dhe 4.3.

4.4 Në rastin e çdo auditimi që do të kryhet nga Bayindirbank Co. apo nga çdo autoritet zyrtar që i takon periudhës pararendëse të transferimit në lidhje me Pjesëmarrjen, Përfituesi/Blerësi bie dakord dhe deklaron se do t'i dorëzojë Transferuesit/Shitësit apo autoriteteve çdo dokumentacion përkatës dhe të kërkuar prej tyre.

4.5 Përfituesi/Blerësi deklaron, njeh dhe pranon se ka shqyrtuar dokumentet kontabël dhe vendet e punës së Pjesëmarrësit të cilat i merr përsipër, që ka kryer vlerësimet dhe kërkimet përkatëse, që Kryetari dhe Anëtarët e Bordit të Drejtorëve, si edhe Auditorët që ishin përgjegjës në emër të Transferuesit/Shitësit përpara periudhave kur Manaxhimi dhe Auditimi i Pjesëmarrjes mbahej nga Transferuesi/Shitësi nuk kanë asnjë lloj

përgjegjësie dhe se i çliron manaxherët në detyrë në emër të Transferuesit/Shitësit gjatë periudhës, që nuk ka të drejtë rekursi për ta detyruar Kryetarin dhe Anëtarët e Bordit të Drejtorëve, si edhe Inspektorët në detyrë në emër të Transferuesit/Shitësit në lidhje me periudhat pararendëse të datës së transferimit të aksioneve të Pjesëmarrjes.

4.6 Transferimi i 60% të aksioneve nga Transferuesi/Shitësi tek Përfituesi/Blerësi do të jetë subjekt i miratimit nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) dhe Korporata Ndërkombëtare Financiare të cilat mbajnë 40% të aksioneve, si edhe të drejtën për të qëndruar në manaxhimin e BKT-së si edhe të Bankës së Shqipërisë. Palët e kësaj Marrëveshjeje njohin dhe pranojnë se në rast se brenda periudhës prej 120 ditësh kalon afati nga data në të cilën është firmosur kjo Marrëveshje nga Përfituesi/Blerësi, pëlqimi i organizatave për Marrëveshjen e lartpërmendur nuk jepet pavarësisht të gjitha përpjekjeve, palët në mënyrë unilaterale dhe pa asnjë njoftim dhe zhdëmtim do ta mbarojnë këtë Marrëveshjeje.

Dispozitat 5.6 të kësaj Marrëveshjeje janë të rezervuara.

4.7 Në varësi të kushteve dhe dispozitave të kësaj Marrëveshjeje, Transferuesi/Shitësi do të dorëzojë gjendjen e aksioneve (titujve, zotërimeve) fillestare apo të përkohshme tek Përfituesi/Blerësi.

4.8 Pas miratimit dhe marrjes së lejes nga EBRD,IFC dhe autoritetet shqiptare në lidhje me transferimin e aksioneve që janë subjekt i kësaj Marrëveshjeje, Transferuesi/Shitësi do të ndihmojë deri në masën e kërkiara dhe të lejuar nga legjislacioni në fuqi përta i takon (a) marrjes së rezolutës të bordit të drejtorëve në lidhje me transferimin e aksioneve, (b) regjistrimit të Përfituesit/Blerësit si pronari i ri i aksioneve të transferuara në regjistrin e aksioneve të Pjesëmarrjes, (c) marrjes së vendimit për shpërndarjen e detyrave të anëtarëve të bordit të Drejtorëve dhe caktimin e firmëtarëve të autorizuar të Pjesëmarrjes dhe përfundimit të transferimit të aksioneve dhe dorëzimit të vendimit dhe dokumenteve përkatëse.

Neni 5- ÇMIMI I SHITJES DHE PAGESA

Përfituesi/Blerësi me anë të kësaj Marrëveshjeje bie dakord dhe deklaron në mënyrë të përvokueshme të bëjë pagesën sipas kushteve që mëposhtë vijojnë në shkëmbim të Aksioneve që ka marrë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje.

5.1 Përfituesi/Blerësi do të paguajë 11.392.691 USD, që i korespondojnë 60% të ekuiteteve (kapitalit të kontributit) në bilancin e audituar (Shtojca 1) të datës 31/12/2003 në datën e transferimit të aksioneve në llogarinë nr. 1-393993-902 në Zyrat Qendrore të Bayindirbank (USD), pagesë e cila do të bëhet me një shumë të vetme dhe në cash.

5.2 Përfituesi/Blerësi do të paguajë shumën që i korespondon 60% të rritjes së ekuiteteve midis periudhës së bilancit të audituar me datë 31/12/2003 (Shtojca 1) dhe bilancit që do të përpilohet që nga data e transferimit dhe që do të auditohet brenda 2 muajve pas datës së transferimit të aksioneve në llogarinë e Bayindirbank të specifikuar në Nenin 5.1, pagesë e cila do të bëhet në cash. Megjithatë, në rast se ka ndonjë rritje të ekuiteteve brenda periudhës midis 31/12/2003 dhe Datës së Transferimit të Aksioneve, Transferuesi/Shitësi brenda 2 muajve pas datës së shumës së kërkuara që i korespondon 60% të ekuitetit do të ulë, ose në rast se kërkesa i duket e papërshtashme do të mbyllë Marrëveshjen dhe do të anulojë shitjen. Në rast se shitja është mbyllur, do të kthejë shumën e transferimit që ka arkëtuar nga Blerësi.

5.3 Përfituesi/Blerësi do t'i paraqesë Bayindirbank në datën e transferimit të aksioneve letrën bankare të garancisë për shumën e specifikuar në Nenin 5.2

5.4 Garancia prej 10% e 11.392.691 USD që do të paguhet si shuma e transferimit të aksioneve sipas dispozitave të Nenit 5.1 (1.136.269 USD) do të dorëzohet nga Përfituesi/Blerësi në datën e nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje me lira turke apo Bono Thesare në USD/bono qeveritare apo me EURO bono të emetuara nga Republika e Turqisë në Tregjet ndërkombëtare në llogarinë depozitë të Bayindirlikbank apo do të depozitohet në llogarinë e selisë qendrore të Bayindirbank nr. 1-393993-902, pagesë e cila do të jetë në cash dhe me një shumë të vetme. Përfituesi/Blerësi gëzon të drejtën të ndryshojë llojin e garancisë që jep në çdo kohë që dëshiron, me kusht që ky lloj të jetë i përfshirë në sa më sipër. Kur shuma e transferimit të jetë paguar plotësisht, garancia prej 10% e specifikuar në këtë nen do të kthehet nga Transferuesi/Shitësi.

5.5 Pas miratimit të transaksionit të shitjes nga aksionerët e tjerë, përkatësisht, EBRD, IFC dhe Banka e Shqipërisë, në rast se pjesa në cash e çmimit të shitjes në përputhje me nenin 5.1 nuk depozitohet nga Përfituesi/Blerësi brenda 120 ditëve pas datës së nënshkrimit të kësaj

Marrëveshjeje dhe në rast se letra e garancisë e lëshuar sipas nenit 5.3 nuk i është paraqitur Bayindirbank, garancia e nenit 5.2 do të futet si faturë.

5.6 Palët e kësaj marrëveshjeje deklarojnë se sipërmarrja e Përfituesit/Blerësit për të blerë aksionet sipas kësaj Marrëveshjeje jepet me kusht të faktit që ky transferim të bëhet I vlefshëm në datën kur Marrëveshjet e partneritetit të EBRD-së dhe IFC-së të jenë firmosur nga Kentbank Co që garancitë e marra sipas nenit 5 ti kthehen menjëherë Përfituesit/Blerësit. Në rast se ndodh ndonjë ndryshim kundër Përfituesit/Blerësit në kushtet e kësaj Marrëveshjeje partneriteti dhe këto ndryshime nuk pranohen me shkrim nga Përfituesi/Blerësi. Marrëveshjet e partneritetit të EBRD-së dhe IFC-së janë Marrëveshje Aksionerësh, Marrëveshje Put and Call dhe Mbështetje Sponsorizimi dhe Marrëveshje Garancie, Statut dhe Deklaratë e Politikave Operative.

NENI 6- PËRFUNDIM I MARRËVESHJES

Pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, në rast se nuk merret miratim apo pëlqim brenda 120 ditëve nga autoritetet shqiptare në lidhje me transferimin e aksioneve, që është edhe subjekti i kësaj Marrëveshjeje, Palët gëzojnë të drejtën ti japin fund kësaj Marrëveshjeje në mënyrë unilaterale pa kërkuar njoftim apo kundërshtim të mëtejshëm. Përfituesi/Blerësi do të ushtrojë të drejtën për përfundim me kusht që të ketë plotësuar informacionin dhe kërkesat për dokumente të autoriteteve shqiptare. Në rast se kjo Marrëveshje përfundohet brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje, Përfituesi/Blerësi do të kthejë garancitë e specifikuara në Nenin 5 që ka marrë nga Transferuesi/Shitësi.

NENI 7- MARRËVESHJE E VETME

Kjo Marrëveshje është e vetmja marrëveshje midis Palëve në lidhje me subjektin dhe është mbi çdo marrëveshje tjetër dhe anullon çdo dhe të gjitha sipërmarrjet, Marrëveshjet, marrëveshjet me shkrim apo verbale pararendëse të datës së nënshkrimit.

NENI 8- LIGJET NË FUQI DHE GJYKATAT

Kjo Marrëveshje dhe çdo e drejtë apo detyrim që lind në lidhje me të do të jetë objekt i ligjeve të Republikës së Turqisë. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të hartohen në përputhje me legjislacionin turk në fuqi dhe

Gjykatat qendrore të Stambollit dhe Zyrat e Përmbartimit do të kenë juridiksion mbi çdo mosmarrëveshje që lind nga kjo Marrëveshje.

NENI 9- AMENDAMENTE, TRANSFERIMI DHE PËRCAKTIMI

Asnjëra nga palët e kësaj Marrëveshjeje nuk gëzon të drejtën të ndryshojë, transferojë dhe caktojë të drejta dhe përgjegjësi që lindin në lidhje me dhe që lindin nga kjo Marrëveshje, pjesërisht apo në tërësinë e saj, tek palë të treta, vetëm me përjashtim të rastit kur palët e tjera kanë shprehur pëlqimin me shkrim paraprakisht për sa më sipër. Të gjitha periudhat e specifikuar në këtë Marrëveshje do të shtyhen nga Bayindirbank deri në masën që kërkohen 10 ditë përpara dhe nga Përfituesi/Blerësi me arsye të justifikueshme.

NENI 10- TAKSA DHE DETYRIME TATIMORE

Çdo lloj takse, detyrimi apo tarife që lind në lidhje me këtë Marrëveshje dhe kryerjen e detyrimeve që lindin nga kjo Marrëveshje do të paguhet plotësisht nga Përfituesi/Blerësi veçmas nga shuma e transferimit.

NENI 11- MARRËVESHJE DETYRUESE

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi dhe është detyruese për palët që nga data e nënshkrimit të saj.

NENI 12- HYRJA NË FUQI

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e firmosjes nga Palët.

Kjo Marrëveshje që përmban 12 nene është ekzektuara dhe firmosur nga palët në dy kopje me datë...2004.

Transferuesi/ Shitësi
Bayindirbank Co.

Përfituesi/Blerësi
Calik- Seker Consortium Investment Co.

Shtojcat

Shtojca 1- Bilanci dhe të ardhurat 31/12/2003

Rezoluta nr. 444

Me shqyrtimin e letrës së Fondit të Sigurimit të Depozitës së Kursimeve (Fondi) të datës 17.10.2005 nr. TMSF 02.IST.56 të paraqitur si bashkëngjitur në letrën e Bordit të Fondit të datës 19.10.2005,

U ra dakord Marrëveshje e transferimit të aksioneve të shtyhet për herë të fundit deri me datë 31/12/2005 për të bërë të mundur përfundimin e transaksionit për shitjen dhe transferimin e aksioneve të Bayindirbank Co në Bankën Kombëtare Tregtare për shkak të vonesave të shkaktuara nga IFC dhe EBRD, që janë aksionerët e tjerë të Bankës Kombëtare Tregtare, dhe Marrëveshja Shtesë nr. 2, e paraqitur si Shtojcë e firmosur nga Calik Seker Consortium Investment Co dhe Bayindirlik Co.,

Që problematika e lidhur me marrjen e letrave të garancisë në kuadrin e kësaj Marrëveshjeje të vlerësohet nga Bayindirlikbank Co.

Firma – Vula

Marrëveshje shtesë nr. 2

MARRËVESHJE SHITESË NR. 2

Kjo Marrëveshje Shtesë nr. 2 (Marrëveshje Shtesë nr. 2) hartohet me datë 5 korrik 2005 midis Palëve, megjithatë vlefshmëria e saj nis nga data 30 qershor 2005.

Kjo Marrëveshje Shtesë nr. 2 është pjesë integrale dhe shtojcë e Marrëveshjes (Marrëveshja) të përfunduar me datë 27 prill 2004 dhe Marrëveshjes Shtesë nr. 1 (Marrëveshje Shtesë nr. 2) të konkluduar me datë 24 mars 2005 midis Calik Seker Consortium Investment Co. dhe Bayindirlikbank Co.

Ndërsa periudha e kësaj marrëveshjeje u shty deri me datë 30 qershor 2005 me Marrëveshjen Shtesë, kësaj here, duke qenë se kësaj periudhe tashmë I ka kaluar afati, marrëveshja dhe marrëveshja Shtesë janë shtyrë deri me datë 31 dhjetor 2005, së bashku me të gjitha dispozitat përkatëse.

BAYINDIRBANK CO.

CALIK SEKER CONSORTIUM INVESTMENT CO.

Firma- Vula